



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 20.04.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.04.2018 (ora 20:18) të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ABKOS" për aktivitetin: "Blerja e paisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorrë dhe ekstrakt-shkumë për BPZ-në në Prishtinë" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-376-121 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "ABKOS" e datës 18.04.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Blerja e paisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorrë dhe ekstrakt-shkumë për BPZ-në në Prishtinë" me Nr.616 18 376 121 Nr. Brendshëm 616 18 121 kundër *Njoftimit për dhënie të kontratës* të AK –së, të datës 09.03.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi për dhënie të kontratës* i publikuar me datë: 16.04.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Albkos" me datë 18.04.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Blerja e paisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorrë dhe ekstrakt-shkumë për BPZ-në në Prishtinë" me numër 616 18 376 121. Autoriteti Kontraktues, me datë 19.04.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1.Lidhur me pretendimet për mosplotësimin e kerkesave teknike kemi kërkuar edhe njeherë sqarim nga njësia e kerkesës dhe të njejtat ua paraqesim në vijim:

Përmes këtij e-maili , me qëllim të sqarimit lidhur me kërkesën për rishqyrtim qe e ka dorëzuar OE-ik ALBKOS për tenderin **Blerja e pajisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorrë dhe ekstrakt-shkumë për BPZ-Prishtinë** .

Ø Gjatë vlerësimit të ofertave , ne përputhje me nenin 72 te LPP, dy herë kemi kërkuar dokumente shtesë nga O. E me çmimin më të lirë , të cilat i ka ofruar O.E (siç janë katalogët të nënvizuara ) .

Ø Në këto katalogë ku janë të nënvizuara specifikat teknike për pajisjet e AKRR-së , janë ato të cilat i plotësojnë specifikat teknike të kërkuara .

Ø Si komision , për OE-ik ALBKOS **nuk kemi thënë** që nuk plotësohen specifikat teknike , por ka qenë në pyetje çmimi .

Gjatë vlerësimit të katalogut që e ka ofruar O.E me çmimin më të lirë , kemi vlerësuar këto specifika dhe kemi renditur kodet e pajisjeve të cilat i plotësojnë specifikat , dhe kemi kërkuar që OE me rastin e furnizimit me këto pajisje të sjellën me etiketa me ato informacione , përndryshe nuk do pranohet asnjë pajisje tjetër;

dhe sqarimet paraprake qe janë dhënë gjatë vlerësimit:

**Vlerësimi i tenderit për gypa –zorrë , ekstrakt-shkumë , dhe pajisje të AKRR-së .**

- Në bazë të vlerësimit të tenderit për këta artikuj , ku kanë aplikuar dy operator ekonomik , dhe për shkak të rëndësisë të këtyre artikujve në veçanti për pajisjet e AKRR-së , kemi kërkuar që të na ofrohet dokumente shtesë (katalogë) nga OE me çmimin më të lirë për këtë tender .
- Pasi që OE ka sjellë katalogun më të ri nga prodhuesi për pajisje të AKRR-së , me kujdes të shtuar është bërë vlerësimi i këtyre pajisjeve duke i krahasuar specifikat teknike të nënvizuara në katalog me specifikat e kërkuara dhe specifikat teknike të nënvizuara i plotësojnë artikujt me kode si në vijim :
- ✓ **Prerës hidraulik ( të vogla për pedale dhe timon ) – CU 4007C**
- ✓ **Prerëse Hidraulike ( gërshërë për prerje )- CU5040**
- ✓ **Tehet shtesë për gërshërë –blades set 30 standard**
- ✓ **Gërshërë të kombinuara hidraulike ( për hapje dhe prerje )- CT4150C**
- ✓ **Tokmak Hidraulik –TR 5350 LP**
- ✓ **Mbështetës për Tokmak Hidraulik-Ram mbështetës HRS 22 , HRS 22 NCT , kompletin Rim adapter set .**
- ✓ **Pompa për pajisje – SR 20PC 2 E**
- ✓ **Set për menaxhimin e xhamave -Kompleti i dhënë : Rescue Support Bag dhe në këtë komplet të vijë edhe pajisja për prerjen e xhamave ( Glass master) .**

Vërejtje –:

**Gjatë furnizimit me këto pajisje , po çdo pajisje të ketë etiketën me specifikat , në mënyrë që komisioni për pranim të mund të bëjë krahasimin e këtyre specifikave .**

**Propozim**

~~Të gjitha vërejtjet e dhëna nga OE-ik ALBKOS, ishin vërejtje në certifikata, me pretendimin se nuk janë origjinale?~~

~~Për këtë ju propozojë që të kërkohet nga OE me çmimin më të lirë, që të sjellë certifikata dhe katalogë origjinale nga prodhuesi.~~

Nga sqarimet dhe konstatimet e dhëna pas dhe gjatë vlerësimit nga personat kompetent të Njesisë së kërkesës dhe nga dëshmitë e kërkuara nga OE-ik "Pastor Kosova" është konstatuar se artikujt e ofruar i plotësojnë të gjitha kërkesat teknike dhe nga kjo rrjedh se pretendimet tuaja lidhur me këtë janë të pa bazuara, ndërsa për sa i përket dhënës së dëshmive të rrejshme nga tenderuesi i propozuar për kontratë në këtë nuk mund ta verifikojmë, por ju nëse keni argumente na i ofroni që ne të vazhdojmë më tutje me procedurat tjera ose nëse mendoni se ato janë vetëm për ju, atëherë mund ti përdorni si dëshmi për ankesë në OSHP.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit